



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE



Nr. i Protokollit: 02/ 682
24/06/2025

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Pjetërshticë

E martë, më 10 qershor 2025

Kohëzgjatja e takimit: 19:45 –21:10

Vendi i takimit: SHMFU 'Idriz Ajeti'

Të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu, Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi, Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini, Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa – Besnik si dhe Drejtori i Shërbimeve Publike - Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1. Korniza Afatmesme Buxhetore 2026-2028

Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu: Përhëndetje për të gjithë ju, faleminderit që keni nda kohën e juaj dhe keni marr mundit që sot të jeni këtu. Siç e keni pa kjo ftesë është bërë për dëgjime publike për buxhetin e vitit 2025-2026, ju e dini që janë dy mënyra që të buxhetohen projektet, njëra rrugë është kërkesat e komunitetit direkt, që janë domethënë kërkesat e juaja, e ana tjetër janë premtimet të cilat ne i kemi dhënë si qeverisje në krye të radhës kur kemi ardhur të u'a kërkojmë besimin. Këto dy komponenta janë ato të cilat e bëjnë çdo vit që ne të jemi këtu dhe t'i marrim kërkesat e juaja t'i buxhetojm dhe më pas ato projekte të realizohen.

Ky është viti i katërt që ne po vijm këtu, ne i kemi 22 vendbanime në Komunën e Shtimes, buxheti i Komunës ju e dini që për t'i mbuluar të gjitha kërkesat e juaja, është i vogël, janë 11 milion euro buxhete këtë vit, edhe pse është rritur ky buxhet, prap në investimet kapitale janë diku rreth 2.5 milion euro.

Ne jemi munduar çdo vit në mënyr të barabartë dhe në mënyrç racionale në secilin vendbanim të dërgojmç projekte pa bërë ndarje politike e as ndarje të tjera. Duke shtuar faktin që kësaj radhe, jo për mburrje pa keqkuptime, na ka buzëqeshur fati që e kemi pasur edhe mbështetjen direkte të qeverisë. Kemi marrur kisa projekte të cilat i keni parë edhe në ministrit e linjës, të cilat na kanë ndihmuar t'i kryejm disa punë mjaft të mëdha të cilat me buxhet të komunës nuk do të mund të realizoheshin.

Ne sot jemi këtu për buxhetin komunal, për buxhetin e vitit të ardhshëm, kisha pas dëshirë që secila lagje të paktën të ketë nga një përfaqësues dhe t'i adresoni kërkesat.

Sot jam këtu me bashkëpunor, me Kryesuesin Adnan Ademi, me Drejtorin e Urbanizimit, Grejtalb Emini, Drejtorin e Financave, Besnik Ahmeti, Drejtorin e Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti si dhe me Gentiana Mehmetin nga kabineti jonë.

Fjalën tani u' a kishin kaluar secilit prej jush.

Kërkesat e banorëve :

- **Brahim Brahim:** Problemin më të madh në si fshat e kemi me ujin, rrjeti sekondar është kryer, gypat kanë ardhur deri te shtëpit, prandaj nuk është edhe shumë vështirësi që të rregullohet.
E dim që fshati ka nevoja shumë të mëdha, mirëpo e dim edhe mundësin e komunës që nuk mund t'i plotësoj të gjitha kërkesat, por duhet të shikohet ku është më e nevojshme që aty të fillohet. Këtë mbetur edhe disa rrugica pa asfaltim dhe ndriçim, nëse do të mund të rregulloheshin edhe ato do të ishte mirë.
- **Bajram Gashi:** Prej interesave të përgjithshme të fshatit, unë e kisha cek kanalizimin, në disa pjesë ka, ndërsa në disa pjesë duhet disa rehabilitime, pastaj jo dhe të gjitha shtëpit janë të kyqyra, disa prej kostos së madhe që duhet të shkoj deri te shaktet e kanalizimit. Ju po ashtu i përmendët në Godanc që janë kontratat për kanalet kulluese, në i kemi disa ara edhe pse fshati jonë njihet më shumë si fshat kodrinor malor dhe pak ka tokë pune, një pjesë e asaj toke janë 4-5 hektar të cilat punohen me vështirësi, po ashtu edhe kur punohet rendimentet janë më të ulta për shkak të ujit të cilën ato e kanë.
Ndërsa sa i përketë interesave të lagjes, rruga "Idriz Ajeti", ajo rrugë ka nevojë për rehabilitim, pasi që është dëmtuar nga arsye të ndryshme. Po ashtu në këtë pjesë është edhe një urë e cila është dëmtuar mjaft shumë dhe ka nevojë për rregullim.
Edhe një kërresë tjetër nga të përgjithshmet, është një pjesë para shkollës që ka mbetur si një far llojë djerrine dhe nuk është as në shfrytëzim të ambulants dhe as të atë të shkollës, kështu që mundësisht të lirohet dhe të bëhet pjesë apo të shfrytëzohet nga shkolla.
- **Hyzer Dugolli:** Problemi kryesor i këtij fshati është rryma, asnjëherë nuk kemi pasur asnjë investim sa i përketë rrjetit elektrik. I vetmi është fshati Pjetërshicë në të cilën nuk është bërë asnjëherë as edhe një intervenim. Nëse ka mundësi të bëhet një kërkesë tek KEDS për riparimin e rrjetit elektrik.
- **Qerim Gashi:** Të zgjerohet ura te rruga kryesore. Po ashtu të rregullohet asfalti te Xhamia pjesa e cila është dëmtuar.
- **Agim Dugolli:** Shtabi në Pjetërshicë si dhe parku te shkronjat e UÇK-së.
Ujësjellsi dhe kanalizimi të rregullohet.
- **Shaban Gashi:** Kemi probleme me kanalizim verës nuk mund të qëndrosh jashtë nga aroma e keqe.
- **Milaim Bajrami:** 150m asfalt dhe 500m drita. Gjithashtu edhe rrugën "Musolli" ka nevojë për një shtresë sepse është dëmtuar.

- **Naim Musolli:** Të vazhdohet ndriçimi tek rruga “Kadri Musolli”, pasi që ka mbetur në gjysëm. Si dhe në rrugën “Dushkaja”, të bëhet ndriçimi.
- **Sabit Gashi:** Rruga Idriz Ajeti”, të zgjerohet, po ashtu është e dëmtuar ka nevojë edhe për rivitalizim si dhe ndriçim.
- **Avni Dugolli:** Rruga “Aziz Dugolli”, kur do të shtrohet asfalt. Rugë e arave afër restaurant Besimit comerc, 500m rrugë të arave.
- **Hysni Dugolli:** Rruga “Peja” a do të shtrohet zhavorr në mënyr që të hapet rruga.
- **Flamur Gashi:** Në rrugën “Idriz Ajeti”, të hiqen pengesa e cila është vendosur, po ashtu edhe një shtyll është në gjendje të keqe është mirë të hiqet pasi që unë nuk po mund ta kthej autobusin tek Xhamia.
- **Kadri Gashi:** Ujësjellësi është tejet i nevojshëm të rregullohet. Problemin me rrymën e kemi të madh, jo vetëm problem por edhe çështja e rrezikut nga ajo. Shtrati i lumit duhet të rregullohet. Është e nevojshëm dhe imediate të bëhet një nënkalim te market Azemi, për shkak të kalimit të rrugës kryesore ku makinat lëvizin me shpejtësi të madhe, ku kemi pasur në të kaluarën aksidente dhe që të mos përsëriten prap. Komplet rrugët në fshatin Pjetërshticë duhet të zgjerohen. Është e nevojshme të shkronjat e UÇK-së të bëhet një park. Ndriçimi publik mungon në rrugën “Ized Ajeti”.
- **Xhavit Dugolli:** 80m asfalt në rrugën “Ajet Gashi”
- **Shkëlqim Sadiku:** Kanalizimi në lagjen “Dugolli”, 300m.
- **Lutfi Gashi:** Shkolla e vjetër duhet të rrënohet, rrethojat e shkollës duhet të bëhen nga 3 anët, po ashtu dhe parkingu brenda oborrit të shkollës duhet të bëhet. Pjesa përballë shkollës është pronë e ambullantës mirëpo ajo pjesë ka mbetur e pashfrytëzuar, nëse ka mundësi t’i dhurohet shkollës për shfrytëzim. Ne e kemi liruar pjesën për stacion të pritjes, mirëpo ka mbetur pa u finalizu shtroja apo asfalti i atij stacionit. Një trotuar që e bënë lidhjen nga Xhamia deri tek shkolla. Shenjëzimi duhet të bëhet për shkak të rrezikshmëris së lart që ka në rrugë. Pastrimi i varrezave në fshatin Pjetërshticë.

Procesmbajtës,
Gentiana Mehmeti





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve në dëgjimin publik në: *Petershticë*
Date: *10/06/2025*

| Nr | Emri dhe Mbiemri | Nenshkrimi |
|----|---------------------------|-----------------|
| 1 | <i>Behram Gorbo</i> | <i>B. Gorbo</i> |
| 2 | <i>MUSLI MUSOLLI</i> | <i>Alen</i> |
| 3 | <i>Brakim Brahimi</i> | <i>Brakim</i> |
| 4 | <i>Milazim Bajraktari</i> | <i>Milazim</i> |
| 5 | <i>Shaban Boj-nengon</i> | <i>Shaban</i> |
| 6 | <i>Hyse Goshi</i> | <i>Hyse</i> |
| 7 | <i>Lutfi Gashi</i> | <i>Lutfi</i> |
| 8 | <i>Arben Gashi</i> | <i>Arben</i> |
| 9 | <i>Kadri</i> | <i>Kadri</i> |
| 10 | <i>Avni DUGOLLO</i> | <i>Avni</i> |
| 11 | <i>QERIM GASHI</i> | <i>Qerim</i> |
| 12 | <i>Hysni</i> | <i>Hysni</i> |
| 13 | <i>SABIT GASHI</i> | <i>Sabit</i> |
| 14 | <i>Osman Musolli</i> | <i>Osman</i> |
| 15 | <i>QUP SULEJ</i> | <i>Qup</i> |
| 16 | <i>Naim Musolli</i> | <i>Naim</i> |
| 17 | <i>ISMET GASHI</i> | <i>Ismet</i> |

6

| | | |
|----|-----------------|---------|
| 18 | Hyzer Dugalli | Dugalli |
| 19 | HYSRI SUMALI | Dugalli |
| 20 | SEREMIN GASHI | Dugalli |
| 21 | HALIM GASHI | Dugalli |
| 22 | Atgim Dugalli | Dugalli |
| 23 | Bekar Uka | Dugalli |
| 24 | Maklit Dugalli | Dugalli |
| 25 | Hyani Dugalli | Dugalli |
| 26 | Mari Sadiku | Dugalli |
| 27 | Shkelgim SADIKU | Dugalli |
| 28 | | |
| 29 | | |
| 30 | | |
| 31 | | |
| 32 | | |
| 33 | | |
| 34 | | |
| 35 | | |
| 36 | | |
| 37 | | |
| 38 | | |
| 39 | | |
| 40 | | |
| 41 | | |